



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPËSTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	06/ 2024
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	17.12.2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë
Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam
Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik
Enver Shabani - Drejtorja e shërbimeve publike, siguri dhe emergjencë
Bashkim Gashi - përfaqësues e EVSB-së
Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit
Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore
Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së
Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së
Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së
Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-ve
Refki Zogaj - përfaqësues i komunitetit të biznesit
Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e mediave lokale
Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së
Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së
Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve
Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li
Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve
Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj i cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;**
- 3. Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë përdorin substanca narkotike;**
- 4. Përgatitja e planit të veprimit për KKSB për vitin 2025;**

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe i falënderon të gjithë për bashkëpunimin. E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike;

Kryetari - ju duhet të na kuptoni sepse deri sa ato lejohen me hy brenda kufirit të Kosovës dhe shpërndahen nëpër komuna, ne e kemi obligim me gjet një lokacion të përshtatshëm dhe çdo herë nën përcjelljen e inspektorëve së bashku me policinë. Tregu tani ka kalu në Shirokë dhe momentalisht lokacioni se ku mund ta caktojmë është tregu i vjetër.

Afrim Sylaj - është më mirë ti lëmë më afër, te muzeu dhe aty i kontrollojmë më mirë.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor thotë që udhëzimi administrativ për përdorimin e fishekzjarrëve e ndalon afër shkollave 100 m së paku.

Kryetari - shkollat tani kanë me hy në pushim.

Rekomandim: nga data 24 deri më 3 janar lejohet të bëhet shitja e mjeteve piroteknike në hapësirën publike afër muzeut.

Kryetari - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Takimin e vazhdon Nënkryetarja e komunës znj. Mihrije Suka.

Pika 3. Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë përdorin substanca narkotike;

Nënkryetarja - është një pikë e rëndësishme dhe e ndjeshme ku supozohet që edhe të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike që është një dukuri negative.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Stacioni policor në Suharekë është duke kry detyrat e veta sipas ligjeve në fuqi dhe është duke zhvillu aktivitete të ndryshme. Sa i përket situatës, në komunën tonë kemi një situatë të qetë dhe stabile. Stacioni policor në Suharekë ka përgatit edhe planin operativ për festat e fundvitit dhe ky plan është përgatit në mënyrë të detajuar për shkak të fluksit të madh të qytetarëve që vijnë për festat e fundvitit. Në çdo aktivitet do të jetë prezenca policore. Sa i përket pikës, përdorimi i substancave narkotike është shqetësuese edhe në komunën tonë. Së fundi kemi pas disa aksione që janë kry prej policisë së Kosovës në komunën e Suharekës dhe identifikimin e personave, poseduesit dhe ata të cilët bëjnë shitblerje të substancave narkotike. Vendet e identifikuar më herët kanë qenë objektet e pa banuara. Një ndër objektet i cili ka qenë më i theksuar, ka qenë ish Podrumi i verës mirëpo tash për shkak të frekuentimit të madh që aty po përdoret si parking, nuk po mund të qarkullojnë përdoruesit e narkotikëve Mirëpo kanë ndryshe format dhe sot narkotikët përdorin substanca narkotike në ndeja të ndryshme, jasht qytetit, në zona të hapura ku rrin të rinjtë zakonisht. Kemi pas raste kur kemi pas identifikim të personave afër shkollave të cilët janë kontroll nga policia me rroba civile. Më shumë kemi të bëjmë me llojin e mariuhanës që përdoret tek të rinjtë por nuk përjashtohet mundësia me posedim edhe substancave narkotike të llojit të ri. Këtë temë unë kisha kërkuar me ndrysh në të ardhmen për arsye se kanë fillu edhe metodat e përdoruesve të ndryshojnë. Pra, jo të bëhet identifikimi por të bëhet më shumë në parandalimin. Policia e Kosovës është duke e bë një fushatë kundër drogave, duke përgatit fletushka dhe do ti shpërndajmë qytetarëve. Ne kemi mbajte edhe ligjërata nëpër shkolla në bashkëpunim me DKA-në dhe do të vazhdojmë me mbajtjen e ligjëratave për tema të tilla me qëllim që të ndikojmë tek të rinjtë që këto dukuri negative të parandalohen dhe më shumë të parandalohen personat që bëjnë shitjen ose futjen e lëndëve narkotike afër shkollave, afër institucioneve të ndryshme.

Habibe Bytyqi - a keni bërë ndonjëherë analizë për personat të cilët i keni identifikua këtë vit të cilët janë përdorues apo edhe shitës të narkotikëve? A keni bërë abalizë se cila është mosha që më së shumti e përfaqëson këtë grup dhe gjinia?

Afrim Sylaj - në bazë të analizave më së shumti përdoret tek të miturit sidomos mosha 15-21 vjeçare. Mosha më e theksuar është 17 vjeçare në komunën tonë. Të gjithë përdoruesit e narkotikëve janë persona recidivist që ndalohen shpesh nga policia dhe njëkohësisht janë persona që kryejnë vepra penale të vjedhjeve dhe veprime të tjera, si dhunë në familjet e tyre. Gjinia është më shumë mashkullore dhe ka raste më pak të gjinisë femërore.

Adem Dërguti - është shumë shqetësuese kjo dukuri negative dhe mendoj që pak po bisedohet në familje me fëmijë. Ndoshta edhe prindërit nuk e dinë për fëmijën e vet që merret me atë punë të keqe dhe mendoj që klasa e dinë se kush merret me atë punë. Andaj është mirë që kujdestarët e klasave nëpër shkolla me bisedua me udhëheqjen e klasës dhe ata në mënyrë sekrete me bisedu me kujdestarët në mënyrë që sa do pak të ndalohet.

Remzi Bajselmani - është një fazë tranzicioni që po e tejkalojmë ne si shoqëri dhe nuk është situata qysh ka qenë pak para 5 viteve ose 10 viteve. Prej pas luftës ka fillu një liri e theksuar dhe të rinjtë e kanë m' rri një liri të tepruar. Nëpër shkolla është punu shumë në këtë drejtim dhe ne si komunë jemi kujdes shumë dhe fatmirësisht nuk kemi pas raste shumë të theksuara. Çdo ditë ballafaqohemi me situata por çdo shkollë e ka një këshill për siguri në shkollë që është e përbërë prej 5 anëtarëve.

Rekomandim: bashkëpunimi mes policisë dhe qytetarëve që ku do që dyshohet se të rinjtë apo qytarët e komunës tonë përdorin substanca narkotike, ta lajmërojnë policinë.

Rekomandim : DKA të bëj kërkesë në institucionet kompetente të policisë, që të mbaj ligjërata në shkolla të mesme e sidomos nëpër klasa që dyshohet ose vërehet ndonjë lëvizje e dyshimtë që nxënësit dyshohen për përdorimin e narkotikëve.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 4. Përgatitja e planit të veprimit për KKSB për vitin 2025;

Nënkryetarja - meqenëse sot është takimi i fundit, zyrtari ligjor e ka për detyrë ta përgadit planin e punës për vitin e ardhshëm. Ia jap fjalën zyrtarit ligjor.

Avni Bytyqi - unë si koordinator i KKSB-së në bashkëpunim me Kryetarin që njëherit është edhe kryesues i KKSB-së dhe në bashkëpunim dhe me komandantin e policisë, kemi ardhë në përfundim ta harojmë një plan të punës për KKSB-në ashtu siq e kërkon edhe udhëzimi administrativ i MPB-së dhe MAPL-së. Jemi mundu ti trajtojmë disa tema që janë të rëndësishme për komunën tonë mirëpo nuk përjashtohet mundësia nëse keni edhe ju si anëtar të KKSB -së që në kuadër të këtij plani ta përfshini ndonjë pikë që vlerësoni që është e nevojshme të diskutohet për vitin 2025. Pika për identifikimin e vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike, po e ndryshojmë me kërkesën e komandantit dhe po e bëjmë si pikë: vetëdijesimi dhe parandalimi i përdoruesve të substancave narkotike në komunën tonë.

Remzi Bajselmani - është një pikë e rendit të ditës që parashihet në prill. Është e arsyeshme dhe nuk mundemi me zhvlerësua sepse ka rëndësi të trajtohet por me që janë bë shumë vite dhe nuk ka lëvizje shumë jashtë nëpër male, nëpër fusha, është pika për vetëdijesimin e nxënësve për rreziqet nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer nga lufta. Në mars-prill është një vrull rinor emocional që ndodh dhe propozoj që këtu të hyjë si ligjëratë e policisë me u mbajte përdorimi i duhanit, droga, alkooli, delikuenca dhe sjelljet devijante.

Avni Bytyqi - drejtor, nuk e kundërshtoj kërkesën tënde por është kërkesë e Ministrisë së FSK-së të cilët vazhdimisht kërkojnë që të jetë në kuadër të planit të punës çdo vit. Ata e kanë ekipin e vet të specializuar dhe e kanë obligim ligjor dhe moral me mbajte ligjëratë nëpër shkolla për çështjen e mjeteve piroteknike. Ne e kemi vlerësuar që në muajin prill të jetë ligjëratë e tyre por pse jo, cilin muaj ta shohim të arsyeshme drejtori pasi edhe kishte kërkesë, unë jam i gatshëm ta fus në kuadër të planit të punës.

Remzi Bajselmani - unë propozoj që në shkurt të mbahet ligjëratë për parandalimin e përdorimit të duhanit dhe dukurive negative. Në këtë situatë ose policia ose në koordinim me neve me gjet ekspert që vjen e paraqet rastin nëpër shkolla se si ndodh te një përdorues dhe si përfundon ai.

Avni Bytyqi - kur ka qenë Sali Bytyqi drejtor, atë kohë ka fillu me hy ligji për parandalimin e duhanit nëpër objekte të mbyllura dhe ai vazhdimisht ka mbajë ligjëratë me fotografi, me video incizime duke tregu pasojat dhe dukuritë negative të duhanit dhe ka pas efekt në atë kohë. Adresa ku duhet të adresohesh për me mbajë ligjëratë të tilla është Drejtoria e Shëndetësisë.

Habibe Bytyqi - nëse përfshihet edhe duhani, ndoshta është mirë të mbahet në maj pasi që me 31 maj është dita botërore kundër duhanit.

Nënkryetarja - i hedh në votim dy ndryshimet në planin e punës.

Aprovohen ndryshimet

Takimi përfundoi: 10:33

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj